



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:233241
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05736481

CAP.nr.912/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren, Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit, K.R.U. “Gjakova” sh.a, me seli në Gjakovë, kundër debitorit, A... H... H... nga fshati S..., Komuna e Gjakovës, për shkak të përmbarimit të kërkesës në të holla-borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, PPP.Nr.261/21, të datës 25.05.2023, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e kreditorit, K.R.U. “Gjakova” sh.a, me seli në Gjakovë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, PPP.Nr.261/21, i datës 25.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me aktvendimin e ankimuar, PPP.Nr.261/21, të datës 25.05.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit A... (H...) H... nga G... dhe urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, P.nr.481/21 të datës 20.09.2021, anulohet në pjesën që ka të bëjë me periudhën nga data 01.07.2007 deri me datën 31.12.2019, për shumën e përgjithshme të borxhit prej 729.31 Euro. Në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit A... H... H... nga Gj..., i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.481/21, datë 20.09.2021, i lejuar nga zyra përmbarimore e Përmbaruesit Privat Gëzim Gjoshi, për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, për shumën prej 265.76 Euro, për periudhën prej datës 01.01.2020 deri me datën 20.09.2021, me kamatë përkatëse ligjore, duke filluar nga dita e pranimit të urdhrit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur se në rast se debitori parashtron ankesë, kundër këtij aktvendimi, urdhërohet që në afat prej 7 ditëve prej parashtrimit të ankesës, të paguaj garancionin në xhirollogarinë e gjykatës për depozita civile, në shumën prej 81,85 euro (tetëdhjetë e një euro e tetëdhjetë e pesë cent). Në pikën IV të dispozitivit ka vendosur në qoftë se debitori dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, brenda afatit si në pikën -III- të këtij

dispozitivi, ankesa e parashtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është parashtruar fare nga pala ankuuese, tani debitor dhe në pikën V të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar pala kreditore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën e kreditorit, të anulohet aktvendimi PPP.nr.261/21 i datës 25.05.2023 dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedim të serishëm dhe të obligohet debitori ti paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

Përgjigje në ankesën e kreditorit, ka paraqitur pala debitore me propozim që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e kreditorit, të vërtetohet aktvendimin e Gjykatës Themelore.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, K.R.U. “Gjakova” sh.a, me seli në Gjakovë përmes përfaqësuesit të saj, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit, A... (H...) H... nga fshati S..., Komuna e Gj..., në bazë të dokumentit Ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit, me të cilën figuron se debitori i detyrohet kreditorit në borxh në shumën prej 995.07 Euro.

Përmbartuesi Privat, Gëzim Gjoshi, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin P.nr. 481/21 të datës: 20.09.2021, ka lejuar përmbartimin. Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbartimi, debitori me datë 04.10.2021 ka paraqitur prapësim, ku ndër të tjera ka theksuar se kreditori kërkon që të lejohet propozimi për përmbartim me urdhër të përmbartimit për borxhin të cilin debitori nuk e ka ndaj kreditorit apo i njëjti borxh është i parashkruar në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve 29/78 GZ e RSFJ-së në kuptim të nenit 378 me propozim për gjykatën që propozimi për përmbartim i lejuar me urdhër P.nr.481/21 të dt. 20.09.2021 të hedhet poshtë dhe të këputen të gjitha veprimet e të njëjtit ose hedhet poshtë propozim përmbartimi ndaj debitorit si i parregullt dhe këputen të gjitha veprimet e të njëjtit për shkak të parashkrimit absolut të kërkesës. Kreditori me datë 11.10.2021 ka paraqitur përgjigje në prapësim ku për ta vërtetuar faktin se debitori ka bërë pranim të borxhit e argumentojnë pagesat e bëra nga ana e tij, ku bazuar në kartelën e debitorit “Ekstrakti nga librat e kontabilitetit” me datën 09.08.2007 ka bërë pagesën prej 80 Euro, ku fatura mujore ishte 12.65 Euro, andaj me këtë veprim ka bërë ndërprerje të parashkrimit bazuar në nenin 368, par.1 dhe 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata Themelore në Prishtinë duke vendosur lidhur me propozimin për përmbartim me aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.261/21, të datës 25.05.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se fillimisht ka vlerësuar propozimin për përmbartim të paraqitur nga kreditori dhe ka konstatuar se i njëjti është paraqitur konform dispozitës ligjore të nenit 38 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore Nr.04/L-139 (në tekstin e

mëtejme LPP-së) dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara me këtë dispozitë, duke ia bashkëngjitur të njëjtit dokumentin e besueshëm në origjinal, në bazë të cilit kërkohen përmbarimi, përkatësisht ekstraktit e verifikuar nga librat afariste, i cili ekstrakt është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim, në kuptim të dispozitave të nenit 29 par.1 nën par.1.2 dhe par.3 të LPP-së. Sa i përket pretendimit të debitorit, lidhur me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, gjykata e shkallës së parë duke bërë shikimin e shkresave të lëndës, përkatësisht propozimin për përmbarim të parashtruar tek Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë dhe i lejuar nga i njëjti me Urdhrin Përmbarimor P.nr.481/21 të datës 20.09.2021, për borxh në vlerën prej 995.07 Euro, për periudhën nga data 01.07.2007 deri me datën 01.09.2021, si dhe duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afariste, me të drejtë ka vlerësuar se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe të njëjtin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par 1.4 të LPP-së, sipas të cilit parashihet se “*ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi*”, për shumën prej 729.31 Euro, pasi që për detyrimet e krijuara prej datës 01.07.2007 deri me datën 20.12.2012, për shkak të parashkrimit të kërkesës së kreditorit, e këtë duke u bazuar në nenin 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.3/3/1978, ndërsa për periudhën nga data 20.12.2012 e deri me datë 31.12.2019, është borxh i parashkruar konform nenit 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 në të cilin theksohet se “*Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpia*”. Andaj, për këtë pjesë të borxhit, pasi që kemi të bëjmë me shërbimet dhe hyn në kategorinë e parashkrimit të kërkesave një vjeçare, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se ka kaluar afati i paraparë me dispozitat e lartcekura – afati i parashkrimit, pas kalimit të së cilit afat, kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore marrë parasysh kundërshtimin e paraqitur nga këtu debitori, andaj edhe ka vendosur si në pikën I (një) të dispozitivit të aktvendimi. Vendosja në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke refuzuar pjesësisht prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ka ardhur pasi që për këtë pjesë të borxhit nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës, sepse kreditori e ka ndërprerë parashkrimin duke parashtruar propozim për përmbarim me datën 20.09.2021, bazuar në nenin 369 të LMD-së, ku theksohet se “*Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesë*”. Pra, pjesa e borxhit që përfshin periudhën nga data 01.01.2020 e deri me datë 01.09.2021, në shumë prej 265.76 Euro, ka mbetur në fuqi, pasi që për këtë pjesë nuk ka arritur afati i paraparë me dispozitën e lartcekur për parashkrimin e kërkesës. Gjukata e shkallës së parë ka vendosur sikurse në pikën III dhe IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke urdhëruar debitorin, se në rast se parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, nga momenti i parashtrimit të ankesës, i njëjti të deponoi garancinë në gjykatë, në shumën prej 265.76 Euro dhe gjykatës t’ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 paragrafi 2 dhe 4 të LPP-së. Sa i përket shpenzimeve gjyqësore të procedurës përmbarimore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 17 të LPP-së lidhur me nenin 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e kreditorit për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale me arsyetim se aktvendimit të ankimuar i mungojnë faktet vendimtare, dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh pretendimet dhe provat

materiale valide të kreditorit në këtë çështje juridike, nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe pala kreditore nuk ka ofruar prova ose fakte te reja për të vendosur ndryshe.

Pretendimet e kreditorit se gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e ka mbështet në faktin se borxhi i debitorit është parashkruar është në kundërshtim me LMD neni 368 par. 1 dhe 2 ngase debitori me pagesat e kohe pas kohëshme e ka pranuar obligimin e tij, pra kur për borxhin paguhet një shumë e caktuar në emër të këstit atëherë me këtë veprim ndërpritet parashkrimi dhe afati i tij nis të rrjedh prej fillimit. Këto pretendime ankimore nuk i aprovoi Gjykata e Apelit për shkak se me të drejt ka vendosur Gjykata e shkallës së parë kur ka konsideruar se borxhi pjesërisht është parashkruar për faktin se debitori nga kartela e konsumatorit shihet se gjatë kësaj periudhe ka bërë pagesa paushallë, mirëpo nuk ka dëshmi se këto pagesa janë bërë në emër të borxhit paraprak apo në emër të faturave për muajt vijues dhe me vete faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar një marrëveshje për ri programim eventual të borxhit, këto pagesa nuk e kanë bërë ndërprerjen e rrjedhjes të afatit të parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e për të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CAP.nr.912/2023 të datës 27.05.2024

Gjyqtarja
Halide Reka